



Lolita Baholli është Kryeaudituese në Departamentin e Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë në Auditim, nga muaji shkurt 2021 e në vazhdim. Prej tetor 2013 e në vazhdim (2021) ka punuar si audituese e lartë dhe kryeaudituese në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Nga muaji shkurt 2006 – tetor 2013 ka punuar Inspektore - Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Kryeministri. Prej muajit maj 1992 deri në shkurt 2006, ka punuar si audituese e lartë në Kontrollin e Lartë të Shtetit në departamente të ndryshme të auditimit. Nga viti 1985 deri në vitin 1992, ka punuar si ekonomiste/ financiere në

ndërmarrje nacionale.

Lolita Baholli është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, me rezultate të larta, në vitin 1985.

Ka një eksperiencë të gjatë audituese, kualifikime cilësore brenda dhe jashtë vendit në SAI, gjykata llogarish si dhe me organizata ndërkombetare të auditimit, në fushën e auditimit, planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, standartet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, trajnimit për trajnerë, prokurimeve publike, riskut të auditimit, kontabilitetit, antikorrupsionit, etj.

Në vitin 2008 ka marrë titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dhe në vitin 2015 është diplomuar në IT Audit nga Projekti “IDI” – Indi.